



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-26512/24

Kaçanik, 30.10.2024

Në mbështetje të neneve 11, 12 paragrafi 1 dhe 2 (d) dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 043/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, nenin 33 të Rregullores së Punës së Kuvendit, të Vendimit të KK 01 Nr.060/01-23149/24 të datës 30.09.2024, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-26512/24, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 tetor 2024, mori këtë :

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIM TË VENDIMIT 01NR. 104/02-4209/22 TË DATËS 28.02.2022 PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NPK "STACIONI I AUTOBUSAVE" SH.A - KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, bëhet plotësim ndryshimi i pikës 2, paragrafi 2.1 i Vendimit **01Nr. 104/02-4209/22 i datës 28.02.2022** për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusave" sh.a-Kaçanik, ashtu që në vend të anëtarit të këtij komisioni Rustem Zenuni, i cili ka dhënë dorëheqje për shkak të emërimit të tij anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa, në vend të tij caktohet për anëtar, Florina Lika-Vishi.

2. Me plotësim ndryshimet që bëhen në vendimin nga pika 1 e këtij vendimi, Komisioni Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusave" sh.a-Kaçanik, ka këtë përbërje:

2.1 Florina Lika-Vishi	anëtar	nga subjekti politik i PDK;
2.2 Ernesta Krasniqi	anëtar	nga subjekti politik i LVV;
2.3 Murat Burrniku	anëtar	nga Ekzekutivi i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A-Kaçanik; Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01 Nr. 104/02-4209/22
Kaçanik, 28.02.2022

Në bazë të nenin 5 pika 2 e Ligjit Nr. 03L-/087 të Ndërmarrjeve Publike, të nenin (Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Ligji Nr. 04/L- 111 dhe Ligji Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12 pika 2(d) lidhur me nenin 17(f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës(bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 Shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARVE PËR NPK
"STACIONI I AUTOBUSVE " SH.A- KAÇANIK

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve" Sh. A- Kaçanik.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve", SH.A- Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi do të ketë 3 anëtarë: 1 (Një) anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës, në përbërje si vijon:

2.1 Rrustem Zenuni	anëtar	nga subjekti politik i PDK,
2.2 Ernesta Krasniqi	anëtar	nga subjekti politik i LVV,
2.3 Murat Burniku	anëtar	nga Ekzekutivi i Komunës.

3. Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike si dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimit e këtyre ligjeve dy ligjeve.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

6. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli